



Në mbështetje të nenit 12.2 të Ligjit Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe nenit 21, paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018 për Marrëdhënie Pune, Zyra Kombëtare e Auditimit, me datën 01.05.2020, publikon këtë:

SHPLLJE

për Angazhim në Punë dhe Detyra Specifike

I. Angazhim për shërbime: **Tetë (8) Auditor Junior për auditimin e rregullsisë**

Numri i referencës: **AJ/ZKA/09-04/20**

Qëllimi i punës:

Pozita Auditor Junior mbulon detyra profesionale me mbikëqyrje dhe udhëzime të herë pas herë nga udhëheqësi..

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryerja e detyrave me përgjegjësi, të caktuara nga Udhëheqësi i Ekipit (nën mbikëqyrje);
- Përfitimi i njohurive të plota rreth institucioneve të audituara dhe kuptueshmëri të plotë të çështjeve, prioriteteve dhe rreziqet që i ballafaqojnë ato (pako për njohjen e punës);
- Ndihmon Udhëheqësin e Ekipit në planifikim të auditimit në çështje të caktuara;
- Shfrytëzimi i teknikave të sakta analitike dhe gjykimet për të arritur në konkluzione të qëndrueshme në bazë të dëshmive të mbledhura;
- Dhënia e konkluzioneve të sakta në bazë të gjykimit profesional duke u mbështetur në dëshmitë e mbledhura;
- Përgatitja e Letrave të Punës (memo përmbledhëse) lidhur me auditimin e komponentës apo fushës audituese, e cila i është caktuar;
- Kryen detyra tjera të ngarkuara nga mbikëqyrësi.

Përshkrimin e detyrave, së bashku me këtë shpallje e gjeni në faqen e internetit të ZKA-së “Mundësi Punësimi”.

Mënyra dhe periudha e angazhimit për shërbime në punë dhe detyra specifike:

Angazhimi i auditorëve junior bëhet me kontratë për punë dhe detyra specifike për një periudhë të caktuar kohore prej tre (3) muajve. Angazhimi në punë planifikohet të bëhet në pjesën e dytë të muajit maj apo në fillim të muajit qershor. Planifikimi për fillimin e angazhimit në kryerjen e detyrave mund të ndikohet varësisht prej rrethanave të situatës pandemike.

Për shërbimet e kryera, kompensimi bëhet në lartësinë e caktuar me aktet e brendshme të Zyrës Kombëtare të Auditimit për nivelin e pozitës “Auditor Junior”

Kushtet themelore për angazhimin në punë dhe detyra specifike:

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Diplomë fakulteti;
- Të jetë i certifikuar në njëren prej skemave të certifikimit për teknik kontabiliteti apo kontabilist.
- Të kenë përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet, financa apo administratë publike, së paku prej 3 viteve.

Kandidatët të cilët kanë kualifikime më të larta në skemat e certifikimit profesional kanë përparësi.

Mënyra e konkurimit:

Kandidatët e interesuar, aplikacionin zyrtar mund ta marrin në recepcionin e Zyrës Kombëtare të Auditimit apo ta shkarkojnë nga ueb faqja e internetit në adresën: <http://www.zka-rks.org/> dhe mund të paraqesin dokumentacionin në kopje fizike në Divizionin për Administrimin e Dokumenteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në adresën: rr. “Ahmet Krasniqi” nr. 210- Prishtinë apo të aplikojnë përmes faqes së internetit në adresën: rekrutimi@oagks.org.

Kandidatët, aplikacionit duhet bashkëngjitur:

- dëshmitë për kualifikimin shkollor;
- dëshmitë për kryerjen e skemave të certifikimit në kontabilitet;
- dëshmitë për përvojën e punës;
- kopjen e letërnjoftimit.

Aplikacionet dhe dokumentacioni i pakompletuar sipas kërkesave të përcaktuara me këtë Shpallje, nuk do të shqyrtohet.

Shpallja është e hapur pesë (5) ditë, nga dita e publikimit në faqen e internetit të ZKA-së dhe në gazeten online: Koha Ditore” me datën 01.05.2020 dhe mbetet e hapur deri më datën 06.05.2020. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin për Burime Njerëzore, në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.